

Shoqata „Greikoci“

Raport vjetor (2019)

Ossingen ZH (Zvicër), 31 dhjetor 2019

Hyrje

Fillimisht, shprehim falënderimet më të singerta për të gjithë anëtarët dhe sponsorët e shoqatës „Greikoci“. Pa kontributin e tyre nuk do ishin të realizueshme projektet dhe aksionet, të cilat do t'ua prezantojmë në vijim. Gjithashtu, ju urojmë të gjithë anëtarëve dhe dashamirëve shëndet dhe fat në vitin e ardhshëm kalendarik!

Viti 2019 ishte vit i begatë i Shoqatës. Pothuajse mbi 85% e anëtarëve i kanë kryer obligimet e pagesës së anëtarësisë, ku të gjitha projektet u realizuan suksesshëm. Në mënyrë që projektet tona të vazhdojnë me këtë ritëm, ju bëjmë thirrje të gjithë anëtarëve, që të kontribuojnë në rritjen e anëtarësisë, pasi që ata janë mirë të informuar rreth aktiviteteve tona, si dhe mund të ndikojnë te ndonjë një mik apo dashamir, duke e sensibilizuar punën tonë.

Njëkohësisht, kërkojmë që edhe në Kosovë, banorët e Greikocit të kontribuojnë me nga 20 euro për mirëmbajtjen e ambientit. Në këtë pikë, ne duam që të gjithë banorët t'i inkurajojmë që të japin kontributin e tyre për mirëmbajtjen e ambientit, pasi që të gjitha aktivitetet tona u destinohen banorëve të Greikocit.


Turne futbollit në Schönenwerd (shkurt 2019)

Më 10 shkurt 2019, shoqata „Greikoci“ nën udhëqjen e Egerem Zmajlaj, formoi një ekip futbollit, e cila mori pjesë në turnen e futbollit, që u mbajt në Schönenwerd (Kanton Solothurn). Qëllimi i këtij turneu ishte që të rinjtë me prejardhje nga Greikoci të njohin njëri - tjetrin dhe të informohen më shumë rreth veprimtarisë së Shoqatës. Në këtë turne, ekipi e shoqatës „Greikoci“ doli fituese. Aktivitete të tilla do të mbështeten sërish nga Shoqata jonë.



Revista e SHFMU «Dëshmorët e Greikocit» nr. 14 (prill 2019)

Për të katërtën herë, shoqata „Greikoci“ financoi botimin e revistës së shkollës fillore «Dëshmorët e Greikocit». Kjo revistë botohet çdo vit (në prill) për nder të dëshmorëve të fshatit të rënë në luftën e fundit (1998 dhe 1999) në Kosovë. Botues i revistës është Këshilli i shkollës. Revista përmban punime të ndryshme, si: poezi, vizatime, rrëfime apo intervista të nxënësve dhe të mësuesve të shkollës fillore të fshatit Greikoc.



Lojë miqsore për nder të «5 prillit» (prill 2019)

Më 5 prill 2019, për nder të Ditës së dëshmorëve - shoqata „Greikoci“ në bashkëpunim me kompaninë „Eloni Möbelsysteme“ zhvilluan një lojë miqsore futbollit në mes ekipit nga fshati Greikoci dhe bashkatdhetarëve, që udhëtuan nga mërgata për të marrë pjesë enkas në këtë lojë. Organizimi i kësaj loje kishte për qëllim nderimin e datës së 5 prillit dhe promovimin e vlerave sportive në mesin e të rinjve të fshatit Greikoc.



Rregullimi i hapësirës për kryerjen e riteve fetare pranë varrezave të lagjes „Kicaj“ (prill 2019)

Në fund të muajit prill përfundoi realizimi i projektit më të rëndësishëm për shoqatën „Greikoci“ gjatë vitit 2019. Bëhet fjalë për rregullimin e varrezave të lagjes „Kicaj“ të fshatit Greikoc. Me këtë rast është rregulluar hapësira për kryerjen e riteve fetare islame, për varrimin e të vdekurve, si të varrezat qendrore të fshatit.



Rroba sportive për KF „Greikoci“ (maj 2019)

Më 1 maj 2019, shoqata „Greikoci“ dhuroi 26 sete rrobash sportive (dresa, shorce, trenerka, çorape dhe çanta) për KF „Greikoci“. Me këtë aksion, Shoqata mbështet aktivitetet sportive për të rinjtë e fshatit.



Iftar për bashkëvendasit (maj 2019)

Më 10 dhe 17 maj, shoqata „Greikoci“ (gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit) i ftoi banorët e fshatit Greikoc për një iftar të përbashkët. Iftari i parë ishte më 10 maj, ku morën pjesë, diku rreth 90 burra dhe djem. Iftari i dytë u mbajt më 17 maj, ku morën pjesë mbi 120 gra dhe vajza. Iftari për gra dhe për vajza u mbajt për herë të parë. Shoqata „Greikoci“ falënderoi gruan e Xhafer Curraj, e cila vullnetarisht barti të gjitha kostot për organizimin e ushqimit. Një falënderim i veçantë i takon, gjithashtu, „M&A“ market në Greikoc, i cili shpërndau të gjitha pijet falas për këto iftare.



Kabina të pritjes për udhëtarë në lagjen „Kicaj“ (qershor 2019)

Gjatë muajit qershor përfunduan punimet e projektit të radhës nga shoqata „Greikoci“. Bëhet fjalë për një kabinë të pritjes së udhëtarëve në lagjen „Kicaj“ të fshatit Greikoc.

SOS Albania 2019 (dhjetor 2019)

Në kuadër të aksionit SOS Albania 2019, shoqata „Greikoci“ ftoi anëtarët dhe miqtë e saj, që të grumbullojnë mjete për personat e prekur nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 në Shqipëri. Me donacionet e grumbulluara në Greikoc u siguruan rreth 100 pako ushqimore për të prekurit e tërmetit, kurse paratë e tjera të grumbulluara (CHF 10000), kryesisht, nga mërgata u dhuruan për fondacionin „Firdeus“, të cilin e udhëheq Elvis Naçi - person me reputacion të lartë kombëtar.

Rreth shoqatës „Greikoci“:

Themelimi:	17 maj 2015
Selia:	Ossingen ZH – Zvicër
Numri i anëtarëve:	mbi 200
Kryetar:	Rexhep Neziraj (+41 79 489 49 92)
Webfaqja:	www.greikoci.ch
Kontakt:	shoqata_greikoci@gmx.ch
Facebook:	Shoqata Greikoci